

ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .10.2020

**Për mbledhjen Nr. 37, datë 19.10.2020, ora 11:00
Të Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 19.10.2020, ora 11:00** do të zhvillohet mbledhja nr. 37 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1-** Mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit në sektorin e energjisë elektrike
- 2-** Mbi miratimin e rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë
- 3-** Mbi shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020, dhe përditësimin e planit dhjetëvjeçar 2015 - 2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.
- 4-** Mbi aplikimin e shoqërisë OST sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021
- 5-** Mbi kërkesën e shoqërisë “Wenerg” sh.a për marrjen e autorizimit të ERE-s për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë në favor të bankës OTP
- 6-** Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a, për barrësim të aseteve (makineri dhe pajisje) në favor të “OTP Albania” sh.a, për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të Hec-it “Dardha 1”
- 7-** Mbi kërkesën e shoqërisë “Energija D.O.O Veternik” për rinovimin e licencës nr. 316, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 140, date 21.11.2015
- 8-** Mbi kërkesën e shoqërisë “Energija D.O.O Veternik” për rinovimin e licencës nr. 317, seria F15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, të

miratuar me vendimin e Bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 141, date 21.11.2015

9- Çështje të tjera

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI